




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. 01-639/14
Dep. 02	Bi Prot. 01-639/14
Nr. i faq. 02	Data 20.02.2014
Broj stranica 02	Datum 20.02.2014
Nr. pages 02	Date 20.02.2014
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.02.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3287/13 për z. Esad Muharemi – Prokuror në Prokurorinë Themelore të Pejës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-3287-13, për Zyrtarin e lartë, z. Esad Muharemi – Prokuror në Prokurorinë Themelore të Pejës dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z. Esad Muharemi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai është paraqitur në AKK, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Muharemi, ka deklaruar se ai është ç'regjistruar nga lista e Avokatëve në Oda e Avokatëve të Kosovës (Vendimi nr. 114-1/13, DPK-03-297/14) dhe që nga koha e emërimit të tij në pozitën e Prokurorit të shtetit nuk e ushtron me funksionin e tij si Avokat.

Ztr. Muharemi po ashtu ka deklaruar se ka fillur procedurën edhe për shurjen e biznesit të tij të regjistruar si avokaturë në Agjencionin për regjistrimin e bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, z.Muharemi, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK-03-593-14) në të cilën shihet se biznesi privat, "Avokat Esad Muharemi", tashmë është shuar në mënyrë vullnetare (DPKI-03-593/14).

Ztr. Esad Muharemi vazhdon të ushtroj funksionin e tij publik, si Prokuror i shtetit në Prokurorinë Themelore të Pejës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

